



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .4.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË QV NR. 1977/00, QV NR. 1977/01, QV NR. 1977/02, QV NR. 1977/03, QV NR. 2021/00, QV NR. 2021/01, BASHKIA TIRANË, DHE QV NR. 1080/00, BASHKIA BULQIZË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, dhe nenit 93, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V Ë R E N:**

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit, para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar propozimi i Administratorit të njësisë administrative nr. 9, autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjeve të 4 (katër) qendrave të votimit, konkretisht të QV-së nr. 1977/00, QV-së nr. 1977/01, QV-së nr. 1977/02 dhe QV-së nr. 1977/03, nga ambientet e Policisë Bashkiake (ish Aluizni) në shkollën “7 Marsi”, si institucioni më i afërt publik me zyrat e Policisë Bashkiake.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar propozimi i Administratorit të njësisë administrative nr. 11, autorizuar nga kryetari i bashkisë Tiranë, për dhënie autorizim për ngritjen e 2 (dy) qendrave të votimit në ambiente private, konkretisht të QV-së nr. 2021/00, dhe QV-së nr. 2021/01, në lokalit e z. Xhevahir Hysa, me arsyetimin se këto dy ambiente, i plotësojnë kushtet për të shërbyer si qendra votimi, dhe kanë shërbyer dhe në zgjedhjet e mëparshme.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar propozimi i kryetarit të Bashkisë Bulqizë, për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes se 1 (një) qendre votimi, konkretisht të QV-së nr. 1080/00 me adresë: Trebisht-Çelebi (shkolla), dhe të kalojë në shkollën

Data: .4.2023 Nr  
Ora:



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 1977/00, QV-së nr. 1977/01, QV-së nr. 1977/02, QV-së nr. 1977/03, QV-së nr. 2021/00, QV-së nr. 2021/01, Bashkia Tiranë, dhe QV-së nr. 1080/00, Bashkia Bulqizë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

9-vjecare “10 Dëshmorët” Trebisht, fshati Muçinë, me arsyetimin se u shërben më mirë zgjedhësve të asaj zone zgjedhore.

Nga verifikimi i kryer në terren nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton e njëjta situatë, sikurse referohet nga Administratorët e Bashkisë Tiranë, dhe nga Kryetari i Bashkisë Bulqizë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4 dhe nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

#### **V E N D O S:**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 1977/00, QV-së nr. 1977/01, QV-së nr. 1977/02 dhe QV nr. 1977/03 nga ambientet e Policisë Bashkiake (ish Aluizni) në shkollën “7 Marsi”, Bashkia Tiranë.
2. Dhënien e autorizimit për ngritjen e QV-së nr. 2021/00 dhe QV-së nr. 2021/01 në ambientet private, lokal, me pronar z. Xhevahir Hysa, Bashkia Tiranë.
3. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 1080/00 nga Trebisht-Çelebi (shkolla), në shkollën 9-vjecare “10 Dëshmorët” Trebisht, fshati Muçinë, Bashkia Bulqizë.
4. Kryetarët e Njësisve Administrative përkatëse, të afishojnë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
5. Kryetarët e Njësisve Administrative përkatëse, të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: .4.2023 Nr  
Ora:



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së QV-së nr. 1977/00, QV-së nr. 1977/01, QV-së nr. 1977/02, QV-së nr. 1977/03, QV-së nr. 2021/00, QV-së nr. 2021/01, Bashkia Tiranë, dhe QV-së nr. 1080/00, Bashkia Bulqizë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”